

## **OSBE sjell debatet komunale para audiencës së gjerë**

Qytetarët e Kosovës e kanë mundësinë që të shohin se si udhëhiqet komuna e tyre, falë një serie debatesh televizive me kryetarë të komunave, mbështetur nga misioni i OSBE-së.

Studio është gati, zërimi është testuar, kamerat gati për veprim. Producenti i drejtohet audiencës dhe i lut që t'i fikin telefonat mobil. "Nëse keni ndonjë pyetje për kryetarin, shkruajeni në një copë letër që do t'ua japim dhe përcillenit tek ne," thotë ai dhe jep shenjë për fillimin e debatit.

Faik Ispahiu, person shumë energjik rreth 30 vjeçar, është producent i debateve televizive 'Jeta në Kosovë'. Që nga viti 2005, ai dhe ekipi i tij që të gjithë anëtarë të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), një organizatë regjionale e mediave që ka përgatitur mbi 220 debate televizive me tema që mediat tjera zakonisht përpigën t'iu shmangen.

"Ne mbulojmë një mori temash – trafikimin e qenieve njerëzore, korrupsionin dhe keqpërdorimin e fondeve publike", thotë Faiku. Për momentin ai dhe ekipi i tij janë duke përgatitur debatet komunale, të cilat mbështetën nga misioni i OSBE-së në Kosovë.

Nikola Gaon, zyrtar për marrëdhënie me publikun shpjegon: "Këto debate televizive janë një vazhdimësi e debateve parazgjedhore për kryetarë komune, që i kemi përgatitur me BIRN-in në nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar".

Në vitin 2007, votuesit kosovar për herë të parë zgjodhën kryetarët e tyre në zgjedhje të drejtpërdrejta, që gjithashtu ishin temë e debateve televizive.

### **Informimi i votuesve**

"Qëllimi i debateve të atëhershme ka qenë informimi i votuesve për kandidatët për kryetar komunash, për planet dhe platformat e tyre në periudhën para zgjedhjeve", thotë Jeta Xharra, moderatore e emisionit të njohur televiziv 'Jeta në Kosovë' (titulli i emisionit është dhënë sipas emrit të saj) dhe drejtoreshë e BIRN-it në Kosovë.

Seria e debateve të tanishme televizive ka për qëllim pasqyrimin e situatës në komuna dhe të vlerësohet se sa janë realizuar premtimet parazgjedhore.

"Duke i shfaqur këto debate në televizion, ne mundohemi t'i përfshijmë në debat një numër shumë më të madh të qytetarëve se sa që dikush mund ta bëjë përmes takimeve të mbyllura me qytetarë", thotë Jeta Xharra duke cituar një sondazh publik që tregon se më tepër se gjysmë milioni kosovarë i kanë përcjellë debatet parazgjedhore, ndërsa mbi 13.000 të tjerë kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në debate.

### **Kryetarët e komunave në karrigë të nxehtë**

Më 23 shtator kryetari i komunës së Vitisë Nexhmedin Arifi, ishte ndër të parët që zuri karrigen e nxehtë përballë Jata Xharrës, në një studio të improvizuar në

platformën e shtëpisë së kulturës në Viti, përpara një audience prej 450 qytetarësh.

Në radhën e parë ishin ulur anëtarët tjerë pjesëmarrës në debat, përfshirë anëtarët e partive opozitare në kuvendin komunal, OJQ-të lokale dhe mediat, si dhe zyrtari i ekipi komunal të OSBE-së përgjegjës për komunën e Vitisë.

Debati u hap me një kronikë nga premtimet parazgjedhore të kryetarit Arifi, për të vazhduar me një reportazh hulumtues për punën e administratës komunale në një emision televiziv në mes të Jeta Xharrës dhe kryetarit Arifi.

Kronika por edhe diskutimet në vazhdim dëshmuar se shqetësimet kryesore të qytetarëve të Vitisë kanë të bëjnë me keqpërdorimin i pronës komunale si psh. veturat zyrtare; mos-aprovimi i statutit të komunës, që ka krijuar një zbrazëti të madhe ligjore si dhe pretendimet që po bëhet punësimi i zyrtarëve jokompetent. Një vlerësim pozitiv i është bërë mënyrës se si administrata komunale i ka shqyrtuar kërkesat për shërbime civile.

### **Diskutim i hapur i problemeve**

Një e grua e re e cila kishte ardhur për ta përcjellur debatin thotë se ishte një gjë e mirë diskutimi i hapur i problemeve. "Njerëzit shpesh diskutojnë për probleme në komunën tonë, por askush gjer më sot nuk është thirrur që publikisht t'iu përgjigjet akuzave. Unë jam shumë e lumtur që tani kemi filluar të diskutojmë hapur për problemet që na shqetësojnë", thotë ajo.

Sipas Nikola Gaon, OSBE-ja ka vendosur t'i financojë debatet para dhe pas zgjedhjeve me qëllim të promovimit të transparencës dhe përgjegjësisë në administratën komunale dhe njëkohësisht të ndihmojë debatin publik.

Këto debate po transmetohen çdo të enjte në terminin kryesor të televizionit publik të Kosovës, RTK. Deri në fund të vitit 2008, debatet do të mbahen në 20 komuna të Kosovës, ndërsa shtatë debate tjera do të mbahen në muajt e parë të vitit 2009.

"Mendoj se do arrijmë numrin e njëjtë të shikuesve që kemi arritur me debatet parazgjedhore", thotë Jeta.

"Por ka një gjë për të cilën më vjen keq, dhe kjo është se nuk po mund t'i mbajmë debatet në të gjitha 30 komunat e Kosovës", shton ajo duke iu referuar faktit se tri komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe kanë bojkotuar zgjedhjet e vitit 2007.

"Shpresojmë se me ndryshimin e rrethanave politike do të mund të shkojmë edhe në ato komuna", përfundon ajo.

Nga: Mustafa Skenderi

LINKU

Debateve televizive në internet

<http://jetanekosove.com/site/jeta3.php>